

2 Zgjedhjet nacionale 2019
Voto të bashkëvendosësh!

3 Aleanca klimatike e
Zvicrës Demonstratë
kombëtare më
28 shtator në Bernë

4 Marrëveshja për pensione
fuqizohet me 1 shtator 2019
Aplikimet për pensione të
Zvicrës janë falas

Nr. 5 | shtator 2019 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Anketa e rinisë së Unia me rastin e fillimit të shkollimit profesional

Alarmuese: Ngacmimi seksual përditshmëri gjatë shkollimit profesional



Nxënësit-shëgertë në përditshmëri përballen me ngacmim seksual, stres dhe mbingarkim alarmant

Një anketë e rinisë së Unia tregon realitetin alarmues të nxënësve-shëgertë : Një treta e të anketuarve në përditshmërinë e shkollimit profesional janë ngacmuar seksualisht së paku njëherë. Edhe ngacmimet tjera (Mobbing-u), stresi dhe mbingarkimi janë tepër të përhapura. Dhe : gati dy të tretat duhet të bëjnë herë-herë orë të tepërta pune, ndërsa 70% e nxënësve ndihen të stresuar përsëritshëm.

Marrë nga Komunikata për Media e sindikatës Unia, Bernë, 12 gusht 2019

Në anketën e Unia morën pjesë mbi 800 nxënës-shëgertë. Rezultat janë alarmuese : Një e treta e pjesëmarrësve tregon, se gjatë shkollimit kanë përjetuar ngacmim seksual. Më këtë rast femrat (36%) janë me fortë të prekura se sa meshkujt (25%). Shifrat janë veçanërisht të frikshme, nga fakti se nxënësit-shëgertë janë në fillim të jetës së punës dhe shumica ende të moshës minore. « Që kaq shumë persona të rinj kanë bërë një përvojë të tillë, është e frikshme dhe tregon se nxënësit-shëgertë dhe të gjithë punëmarrësit duhet të mbrohen më fuqishëm » thotë Kathrin Ziltener, sekretare nacionale e rinisë në Unia.

Një problem shoqëror që prek edhe nxënësit-shëgertë

Nëse zgjerohet vështrimi përtej vendit të punës në shkollë dhe jetën private, shifrat janë dukshëm më të larta. 80% e femrave të anketuara ka pohuar, të kenë përjetuar ndonjë lloj ngacmimi seksual. Tek meshkujt kanë qenë gati gjysma (48%) viktima të ngacmimit.

Llojet e ndryshme të ngacmimit – shpesh të kombinuara

Tek ngacmimet janë evidentuar llojet e ndryshme të kalimit të kufijve dhe sulmeve të paturpshme (shih edhe përmbledhjen e rezultateve në faqen përkatëse të internetit të Unia). Shpesh këto shfaqen të kombinuara : Nëse fjala bie “aluzione seksuale ose vërejtje pejorative (nënçmuese), të cilat janë format më të përhapura, kështu ishin vetëm 16% e të gjithë të prekurve posaçërisht nga ky lloj ngacmimi të prekur. Kjo tregon se, shpesh pas këtij kalimi të parë të kufirit pason një tjetër formë më me peshë.

Mobbing-u, stresi, mbingarkimi

Shkollimi profesional për shumicën e nxënësve-shëgertë, marrë parasysh ngacmimet e padëshiruara, nuk është sheqerkë. 31% e të anketuarve raportojnë, se vet ata gjatë punës kanë përjetuar Mobbing-un. Nuk mungon as stresi, ngase gati dy të tretat (63%) duhet të bëjnë

orë shtesë pune, edhe pse kjo tek nxënësit-shëgertë është e lejuar vetëm në raste të jashtëzakonshme. Gati gjysme (46%) ndihen herë-herë të mbingarkuar në punë.

Rregullore të qarta dhe kujdestaria do të ndihmonin

Për të përmirësuar kushtet gjatë shkollimit profesional është e domosdoshme të zbatohet mbrojtja ligjore e nxënësve-shëgertë, sa i përket orëve të tepërta dhe punës natën. Për të reaguar drejtë sa i përket problematikës së ngacmimit seksual, ndërmarrjet do të duhej

të zbatonin tolerancën zero karshi veprimeve të paturpshme seksuale dhe për këtë të përpunojnë rregullore të qarta, të krijohet një pikë e kontaktit në ndërmarrje apo jashtë saj si dhe të parashihen sanksione për ata që bëjnë veprime të gabueshme. Pasi që punëdhënësit bazuar në ligjin për barazi janë të obliguar të mbrojnë të punësuarit. Kjo vlen në masë të veçantë tek nxënësit-shëgertë. Politikisht Unia kërkon të përcaktohen provat ngarkuese kur është fjala për ngacmimet seksuale, që viktimat të mund të peshojnë hapat për tu drejtuar në polici.

Studimi

Në anketën e sindikatës Unia kanë marrë pjesë 812 persona (nga ta 514 online – përmes internetit dhe 298 persona përmes pyetësorëve me shkrim). 61% e pjesëmarrësve janë femra, 30% meshkuj dhe 9% nuk kanë dhënë gjininë e tyre, gjegjësisht kanë kryqëzuar kategorinë «të tjerë». 28% e të anketuarve kanë dhënë se janë në vitin e parë të mesimit të zanatit, 22% në të dytin dhe 30% në vitin e tretë. 2% të pjesëmarrësve në lidhje me këtë pyetje nuk japin të dhëna të kuptueshme, gjegjësisht kanë përfunduar shkollimin profesional.

Editorial



Të dashura kolege, të dashur kolegë

Ligji i ri për të huajt dhe për integrim (AIG) po zbulohet si ujë nën lesh dhe leje. Bëhej fjalë për dobinë e madhe për integrim. Tani po dalin në pah pasojat. Kujt i nevojitet mbështetja sociale humb të drejtën e qëndrimit të përhershëm (lejen C). Kthehet në lejen vjetore B. Dhe nëse edhe më tutje nuk i plotëson kushtëzimet restriktive, atëherë duhet të largohet nga Zvicra. Kjo godet njerëzit, të cilët nga çfarëdo arsye duhet të marrin ndihmë sociale, të cilët edhe përkundër punës nuk shëndetësore nuk mund të punojnë me orar të plotë apo fare hiq. Si është rasti i një pensionisti invaliditeti në Bernë. Ai bazuar në ligj merr të ardhura suplementare, pasi pensioni nuk mjafton. Enti për migracionin i Bernës vendos largimin e bashkëshortes së tij. Për fatin e prekuri ndërmerre hapa ligjor të kundërshtimit të një vendimi të tillë.

Ne nuk kemi planetë të dytë dhe na duhet të veprojmë, pasi ne jemi në rrugën më të mirë për të shkatërruar bazamentin tonë jetësor. Njerëzit e rijë, të cilët angazhohen për klimën tonë kanë të drejtë : Është koha 12 pa 5! Lufta e të rinjve duhet të bëhet luftë e të gjithë të majtës të Zvicrës dhe të botës. Andaj, Unia solidarizohet me lëvizjen klimatike në përgjithësi dhe mbështet edhe demonstratën e madhe për klimën të datës 28 shtator 2019. Bashkoju edhe Ti kësaj demonstratë.

Votimi është ditë page! Në tetor janë zgjedhjet për parlamentin e ri. Ndër kandidatët gjenden edhe shumë sindikalistë dhe njerëz të rinj me sfond migracioni. Kush ka të drejtë vote do të duhej të shfrytëzonte këtë të drejtë. Të votojmë njerëzit, të cilët i dalin zot të drejtave të punëmarrësve, të drejtave njerëzore dhe një shoqërie gjithëpërfshirëse.

Hilmi Gashi

News

Stresi dhe ngarkesat psiko-sociale në vendin e punës po rriten

Stresi në punë, qëndrimet trupore të dhimbshme dhe të lodhshme, ankthi për punën dhe stresi emocional po rriten. Këto gjetje të Unia u konfirmuan kah fundi i gushtit edhe nga Zyrës Federale e Statistikave (BfS). Unia kërkon një mbrojtje shëndetësore funksionale, veçanërisht në sektorët tipikë të grave dhe kundërshton sulmet e vazhdueshme ndaj mbrojtjes së shëndetit në ligjin e punës. Pa evidentimin e kohës së punës është vërtetuar dëshmueshëm se punohet më gjatë dhe bilanci i punë – jetë familjare është nën presion; Mbetet shumë pak kohë për pushimi dhe relaksim. Unia do të kundërshtojë me çdo mejt kundër këto shkelje që dëmtojnë shëndetin.

Këshilli i Shtypit i jep të drejtë Unia-s

Në maj të vitit 2018, gazetaret «La Cote» dhe «Arcinfo» publikuan një artikull me akuzat të padrejta dhe jo korrekte kundër Unia. Tani, Këshilli Zviceran i Shtypit ka aprovuar gjerësisht ankesën e sindikatës. Unia mirëpret vendimin e Këshillit të Shtypit. Kjo është një shenjë se «lajmet e rreme» dhe sulmet e pabaza në media nuk janë në rrugë të drejtë. Unia mbron bindshëm lirinë e shtypit, por do të vazhdojë të mbrohet kundër sulmeve gazetareske të drejtuara nga interesi dhe atyre dashakeqe pa baza faktike.

Aksioni i kopshtarëve për një industri të gjelbër me të ardhme

Përmes gjelbërimit simbolik të sheshit «Waisenhausplatzes» në Bernë, kopshtarë nga rajone të ndryshme të Zvicrës kanë tërhequr vëmendjen për punën e tyre dhe kërkesat e tyre: Puna e vështirë duhet t'ia vlejë. Pagat korrekte, pesë javë pushime dhe pensionim i parakohshëm duhet të bëhen realitet edhe në kopshtari! Kopshtarët dëshirojnë një industri të fortë të degës së gjelbër me një mbrojtje detyruese të pagave dhe kushteve të punës. Kjo sjell dobi si për punonjësit ashtu edhe për kompanitë.

Si sindikata më e madhe në sektorin e gjelbër, Unia i bën thirrje shoqatës së punëdhënësve «JardinSuisse» të vijin në tryezën e bisedimeve dhe të punojnë së bashku për të gjetur një zgjidhje të partneritetit shoqëror.

hap i parë, i cili ligjërisht duhet të ankorohet sa më shpejtë.



Pamje nga një protstë e mëhershme e kopshtarëve

Rritje masive e punës me pagë në orë Punëmarrësit paguajnë faturën!

Gjithnjë e më rrallë është e rregulluar koha e punës me kontratë pune. Gjithnjë më shpesh punëdhënësit punësojnë punëtorë me pagë në orë. Kështu ata nuk garantojnë kohën e punës minimale javore e mujore, për çka në fund të muajit jo gjithmonë është shumica e njëjtë në konton e pagës.

Marrë nga Broshura e Unia «Puna me pagë në orë» (përshtatur nga O. Osmani)



Të punësuarit me pagë në orë diskriminohen

Fleksibiliteti i kohës së punës prek të gjitha degët. Fleksibiliteti për punëmarrësi mund të ketë aspekte pozitive (p.sh. rrëshqitje në orarin e punës dhe autonomi e kohës së punës). Por, për shumë punëmarrësi bie me veti ndikime negative, pasi është fjala për fleksibilitet të njëanshëm. Kryesisht punëdhënësi e përcakton kohën e punës. Si pasojë ata para së gjithash edhe përfitojnë nga situatat e tilla. Punëmarrësit në të kundërtën nuk kanë aspak mundësi të planifikojnë jetën e tyre më gjatë. Kombinimi i punës dhe jetës private shndërrohet një akt balancues.

Edhe nëse jeni të punësuar me pagë në orë, ju keni të drejtë në kushte korrekte të punës.

Unia kërkon dhe lufton që:

- çdo kontratë të përmbajë një numër të caktuar javor ose së paku mujor të orëve të punës.
- punonjësit të marrin një shtesë për punën me orë prej 2,27% në orë si pagesë kompensimi për pushime.
- orët e punës jashtë orarit të kontraktuar të punës për të punësuarit me kohë të pjesshme, të paguhen me një shtesë prej 25% ose që ato të kompensohen.
- të ketë sigurim të detyrueshme të kompensimit të të ardhurave të humbura në rast sëmundjeje për të gjithë të punësuarit.
- planet e punës të bëhen të njohura së paku tri javë më herët.
- punëmarrësit, të cilëve në mënyrë afatshkurtër u ndryshohen

planet e punës, të marrin shtesë në pagë.

■ orët e parapara në planet e punës, të përcaktuara nga punëdhënësi, të paguhen tërësisht, edhe nëse punëdhënësi heq dorë nga puna e planifikuar.

■ Nëse punëmarrësit pa fajin e tyre punojnë më pak sesa është paraparë me kontratën e punës, atëherë orët e tyre të humbura duhet të eliminohen në mënyrë periodike, së paku një herë në vit.

■ kompensimi për pushime i punëmarrësve me pagë për orë, të bëhet në kohën e marrjes së pushimeve.

■ të sigurohen kushte të sigurta dhe të rregulluara

Zgjedhjet nacionale 2019 në Zvicër TË VOTOSH DOMETHËNË TË BASHKËVENDOSËSH!

Më 20 tetor ne do të rizgjedhim anëtarët e Parlamentit dhe Senatit. Shumëçka do të varet nga këto zgjedhje: premi më të ulëta të sigurimeve shëndetësore, punë dhe arsimit për të gjithë, barazi gjinore konsekuente dhe mbrojtje të klimës. Ne angazhohemi për një Zvicër të hapur, sociale dhe ekologjike për të gjithë. Sepse Zvicra do të jetë e forte vetëm atëherë kur ndihen mirë të gjithë e jo vetëm një pakicë e vogël.

O. Osmani)

Votë për kandidatët që angazhohen për një shoqëri gjithëpërfshirëse

Në këto zgjedhje kandidojnë edhe shumë sindikalistë dhe njerëz të rinj me sfond migracioni. Kush ka të drejtë vote do të duhej të shfrytëzonte këtë të drejtë. Të votojmë njerëzit, të cilët i dalin zot të drejtave të punëmarrësve, të drejtave njerëzore dhe një shoqërie gjithëpërfshirëse.

SHANSE TË NJËJTA, TË DREJTA TË NJËJTA: NJË ZVICËR EINE PËR TË GJITHË

NJË E DREJTË PËR PUNË PËR TË GJITHË

Të gjithë pa diskriminim duhet të kenë qasje për arsimim dhe punë: Falë nxitjes dhe njohjes së diplomave dhe kualifikimeve tjera profesionale nga vendi amë.

PËR NATYRALIZIM DHE PJESËMARRJE POLITIKE

Një çerek i popullatës nuk ka të drejtë zgjedhjeje dhe vote. Ky deficit i madh demokratik është i papranueshëm. Natyralizimi duhet të lehtësohet dhe të garantohet e drejta për pjesëmarrje politike për të gjithë.

RESPEKT DHE SHANSE TË NJËJTA PËR MIGRANTET

Migrantet shpesh diskriminohen dyfish. Qasja e tyre në punë, arsimim dhe politikë duhet të përmirësohet dukshëm. Vetëm kështu mund të vijë në shprehje potenciali i këtyre grave.

TË PRANOHEN DIVERSITETI DHE DINJITETI NJERËZOR

Popullata në Zvicër është jashtëzakonisht e shumëllojshme. Politika duhet të pranojë realitetin e ri shoqëror dhe të kujdeset për barazi faktike dhe për një shoqëri inklusivë (gjithëpërfshirëse).

UDHËZIMI PËR VOTIM

Procedura e saktë ndryshon nga kantoni në kanton. Në parim, votimi korrekt bëhet si në vijim:

Hapeni zarfin zyrtar të votimit

Ne ju preferojmë të gjatë plotësimin të listës të mbështetjes politike ose personat që punojnë për të drejtat e migrantëve, punëtorëve dhe sindikalistëve.

Shkëputni fletëvotimin e PS-së për senat (Ständerat) ose shkruani emrat e kandidatëve të PS-së në fletën e votimit bosh

Vendose fletëvotimin për senat (Ständerat) dhe listën e deputetëve nacional (Nationalrat) të PS-së në zarfin anonim të votimit

Nënshkruaje kartën e votimit

Vendose zarfin e votimit dhe kartën e votimit në zarfin zyrtar. Adresa e kthimit duhet të jetë e dukshme në dritaren e zarfit zyrtar.

Zarfi i votimit përmes postës duhet deri më 15 tetor ti kthehet prapa komunës, ose deri më 19 tetor të hedhet në kutin e postës së administratës komunale.

Pamje e fletushkës së migrateve/ëve socialdemokratë të Zvicrës me kërkesat dhe udhëzuesin praktik të votimit

Iniciativa kufizuese Iniciativë e rrezikshme e SVP/UDC-së

Më 31 gusht 2018 është dorëzuar iniciativa popullore federale «Për një imigrim të moderuar» (iniciativa kufizuese ose nisma e ndërprerjes). Ajo është nisur nga SVP/UDC dhe është e formuluar qartë. Ajo, që nisma e aprovuar për imigrimin masiv ka mbetur e fshehur dhe e paqartë, tanimë është përkufizuar qartazi. Qeveria federale obligohet të ndërpresë Marrëveshjen për lëvizje të lirë me BE-në (shkurt FZA/ALCP). Iniciatorët duan që migracionin ta rregullojnë sipas mostrave të vjetra të kontingjenteve dhe të anulojnë kontrollin mbi pagat.

Marek Wieruszewski

Edhe qeveria federale hedh poshtë iniciativën

Qeveria federale me 7 qershor 2019 ka sugjeruar refuzimin. Pasoja të panumërta negative janë bërë të qarta. Para së gjithash aprovimi i iniciativës do të rrezikonte ekonominë vendore të Zvicrës dhe vendet e punës.

Përgjysmohet emigracioni nga BE

Iniciativa injoron zhvillimet aktuale. Emigracioni orientohet sipas nevojave të tregut të punës. Që nga viti 2013 emigracioni nga vendet e BE-së është përgjysmuar nga 60000 në 30000. Në Zvicër vijnë vetëm aq njerëz për sa ajo ka nevojë. Falë marrëveshjes të lëvizjes së lirë ata mund të punojnë këtu legalisht dhe të jetojnë me kushte dinjiteti.

Mbrojtja e pagave dhe masat shoqëruese (FlaM)

Një pjesë të rëndësishme të lëvizjes së lirë paraqesin edhe masat shoqëruese (FlaM). Ato lejojnë ndërmarrjen e ha-



pave efektive kundër dumpingut në paga. Punëdhënësit nuk mund të rrisin fitimet e tyre në kurriz të pagave deh të shtypin nivelin e përgjithshëm të pagave në tregun e punës. Heqja e lëvizjes së lirë do të suspendonte edhe kontrollin e pagave dhe do ti hapte dyert gjerësisht për punën në të zezë.

Brexit-i zviceran

Ndërprerja e Marrëveshjes të lëvizjes së lirë do të kishte edhe pasoja tjera negati-

ve, të cilat janë të ndërlidhura me gjithë paketën e marrëveshjes bilaterale I. I gjithë koncepti i suksesshëm i bashkëpunimit bilateral me BE-në do të hiqej dhe Zvicra do rrëshqiste në izolim. Ministria Karin Keller-Sutter ka folur deri edhe për «Brexit-in zviceran».

Për të mbrojtur tregun e punës në Zvicër nevojitet lëvizja e lirë dhe masa shoqëruese mbrojtëse përmes (FlaM).

Aleanca klimatike Zvicër Demonstratë e madhe për klimën me 28 shtator

«Ekologjia dhe kushtet e mira të punës shkojnë bashkë.» Këtë e ka përcaktuar mbledhja e delegatëve të Unia në qershor 2019 përmes një rezolute. Ajo mbështet demonstratën kombëtare në fund të shtatorit në Bernë.

Tubimi: në ora 13.30 në «Schützenmatte» në Bernë

Mënyra në të cilën shoqëria jonë prodhon, ndërton dhe transporton është fajtorë për ndryshimet klimatike. Rritja dhe prodhimi i pakufizuar duke injoruar nevojat e njerëzve jo vetëm që dëmton planetin tonë, por edhe të gjithë punëtorët, të gjithë nxënësit-shëgertë dhe praktikantët/ët.

Popullata punëtore kundër shkatërrimit të planetit

Për një luftë të suksesshme kundër ndryshimeve klimatike dhe shpëtimi i bazamentit tonë jetësor është i pas-

hmangshëm, shkaku i solidarizimit të popullatës punëtore me protestën klimatike.

Aleanca-Klimatike Zvicër

Është themeluar në vitin 2004 dhe është një bashkim i organizatave të shoqërisë civile për mbrojtje të klimës. Me mbi 80 organizatat anëtare të veta ajo angazhohet për një politik klimatike të drejtë dhe të aftë për të ardhmen.

matike. Është detyrë e sindikatave, që rezistencën kundër shkatërrimit të planetit nga shkollat dhe rruga ta barti edhe në ndërmarrje.

Është pesë para dymbëdhjetë

Rinia e klimës ka të drejtë: Është pesë para dymbëdhjetë! Lufta e të rinjve duhet të shndërrohet në luftë e gjithë së majtës të Zvicrës dhe të Botës. Andaj, Unia solidarizohet me lëvizjen klimatike në përgjithësi dhe mbështet edhe demonstratën e madhe klimatike me 28 shtator 2019.



Protestuesit e mbrojtjes klimatike tërheqin vërejtjen se është momenti i fundit për të vepruar

Strategjia dhe planet e Unia mbi politikën e migracionit

Një bisedë me Hilmi Gashin, drejtues i ekipit të grupeve të interesit

Hilmi, në maj ti ke filluar punën si drejtues i migracionit në sekretariat qendror. Si e ndien veten në këtë pozitë tënde të re?

Shumë mirë, faleminderit. Unë kthehem pas 10 vitesh në një sektor «tek rrënjët e mija sindikaliste». Puna është interesante dhe sfidat në sektorin e migracionit edhe më tej shumë të mëdha. Fuqizimi i forcave konservatore të djathta dhe ksenofobe rrezikojnë të arriturat sociale dhe demokratike. Diskursi ksenofob i kultivuar nga SVP/UDC mjerisht është përqafuar edhe nga partitë tjera borgjeze dhe të qendrës. Rezultati shihet më së miri tek ligjet për të huaj gjithnjë e më të ashpra dhe represive. Edhe tek natyralizimi pengesat kanë shënuar rritje masive. Në Zvicër mbi 20% të popullatës janë të përjashtuar nga bashkë-vendosja demokratike dhe politike, edhe pse pjesërisht këtu të lindur, të rritur dhe për faktin se japin një kontribut të rëndësishëm në pasurimin ekonomik, kulturor dhe shoqëror.

Cilat janë qëllimet e sektorit të migracionit?

Sindikata Unia është organizata më e madhe e migracionit. Anëtarët tanë me sfond migracioni janë një resurse shumë e rëndësishme transversale. Ata angazhohen në regjione dhe seksione e jo vetëm në sektorin e migracionit, por janë persona të besueshëm aktiv në degët e tyre ekonomike dhe në organizatat e ndryshme të migrantëve. Këtë forcë dhe solidaritet të jetuar duhet ta theksojmë më shumë. Për të mundur që personat tanë të besueshëm dhe aktiv të kontribuojnë më shumë, nevojiten oferta dhe struktura gjegjëse në regjione. Ne nga sektori i migracionit duam të ndihmojmë në krijimin dhe ndërtimin e këtyre strukturave nëpër regjione, si sa i përket përmbajtjes ashtu edhe metodave.

SVP/UDC-ja sulmon frontalisht lëvizjen e lirë. Ne duhet ta luftojmë me vendosmëri këtë. Ne duam të mbrojmë pagat dhe kushtet e punës dhe jo të ndërtojmë mure përreth Zvicrës.

Cilat janë temat politike në dy vitet e ardhshme?

Anëtarësia jonë e bazës në komisionin e migracionit kanë vendosur që ne të qojmë përpara kërkesën për njohjen e diplomave të huaja. Ne jemi duke punuar për këtë. Një temë më rëndësi për ne si sindikatë është luftimi i iniciativës kufizuese të SVP/UDC-së. Pos kësaj ne do të organizojmë takime informative mbi përqësimet në ligjin për të huaj dhe integrim, me qëllim që ti informojmë njerëzit dhe që ata të mbrohen. Lufta sindikaliste për paga të mira, pensione të sigurta, të drejta njerëzore dhe bashkë-vendosje është një rrugëtim i gjatë dhe i përhershëm. Migrantet/ët në Unia japin këtu një kontribut tejet të rëndësishëm.

Të drejtat e migrianteve/ëve janë duke u reduktuar gjithandej. A mundet Unia ta pengoj apo ta reduktoj këtë? Nëse po, si?

Lufta për më shumë të drejta për migrantet/ët mbetet edhe më tej një luftë e gjatë dhe e vështirë. Në parlamentin e dominuar nga e djathta, një mocion ndjek tjetrin dhe duket sikur politikanët e taborit të djathtë janë në garë, se cili nga ta do të ketë një ide shtesë, për ti kufizuar edhe më tej të drejtat e migrianteve/ëve. Andaj është me rëndësi e ne në zgjedhjet e tetorit të votojmë për sindikalistet/ët. Natyrisht të angazhohemi edhe në përditshmëri gjithandej për një shoqëri të hapur dhe demokratike.

Si mund të sensibilizohen e mobilizohen punëtorët edhe për të drejtat e migrianteve/ëve?

Duke u angazhuar vet ne aktivisht dhe me vetëbesim bë diskutime. Ti tregojmë kolegeve/ëve tanë në botën e punës që politika stigmatizuese është e dëmshme për të gjithë. Duke i jetuar përditë vet vlerat e solidaritetit dhe duke mos lejuar të na përçajmë deh duke u organizuar në sindikata dhe duke u angazhuar bashkërisht për paga më të mira, kushte më të mira pune dhe për të drejtat njerëzore.

Si e sheh ti politikën e migracionit të Unia-s në 5 vite?

Viti i ardhëm është vit i kongresit. Në kongres të deleguarit tanë do ti vejnë binarët për 4 vitet e ardhshme. Ne nga migracioni, në këtë debat të gjerë e të gjallë do të angazhohemi sikur edhe deri më tani aktivisht me ide dhe projekte. Ne bashkërisht me aktivistët sindikal dhe partnerët tanë do të vazhdojmë angazhimin tonë në fushën e migracionit dhe të drejtave njerëzore dhe ta zgjerojmë atë. Fatmirësisht ka shumë njerëz dhe organizata në këtë vend, të cilët nuk janë të pajtimit me këtë politik ksenofobe karshi migracionit dhe larg realitetit. Migracioni e ka pasuruar Zvicrën ekonomikisht, politikisht si dhe në kulturë. Këtë ne duhet gjithmonë ta përsërisim qartë dhe me vetëbesim.

Emine Sariaslan

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Studimi gjatë papunësisë: a marrë unë më pak para kompensimi?

Unë kam përfunduar para 10 vitesh shkollimin tim profesional si kontabilist/e-. Më pas kam punuar në firmë të ndryshme. Shefi im i fundit më ka pushuar nga puna, pasi që firmës së tij i shkonin punët keq. Që nga janari 2019 jam i papunë. Tani dua të arsimohem me tej në profesion, për ti rritur shanset për një vend të ri pune. Unë kam maturitetin profesional andaj edhe mundësinë që krahas punës të studiojë ekonomi ndërmarrëse në njërin nga shkollat e larta profesionale. Unë nga tetori 2019 do të jam të hënave tërë ditën në shkollë – A ka kjo ndikim s ai përket kompensimit të papunësisë?

Markus Widmer: Mjerisht po. Pas fillimit të studimeve tuaja, ju do të keni mundësi të punoni vetëm në shkallën 80%. Andaj paga e juaj e siguruar do të shkurtohet për 20%. Prandaj ju duhet të kërkonti një vend pune me maksimalisht 80% kohë pune. Ne ju rekomandojmë të kontaktoni këshilltarin tuaj të Qendrës rajonale për ndërmjetësim të punës, për të reduktuar ndërmjetësimin tuaj të punës vetëm për 80%.

Work, 28.6.2019



BËJE NJËHERË NJË PAUZË! Punonjësit duhet të largohen nga vendi i punës për të bërë pauzën. (Foto: PD)

Koha e punës: A duhet pauzën ta kalojë në vendin tim të punës?

Unë punoj në orar të plotë gjithë ditën i vetëm në lokalitë shites të një qendre tregtare. Shitoren unë nuk guxoj ta mbylli edhe gjatë pauzës së drekës dhe duhet që gjatë gjithë orarit të punës të shërbejë myshterijë. Në shitore nuk guxoj të ushqehem. Andaj unë ha diçka të vogël vetëm rrugës për në tualet. Shefi im ma heq për këtë një orë pauzë në ditë. A lejohet kjo?

IGOR ZORIC: Jo. Kjo nuk lejohet. Firma duhet të organizojë punën e juaj në atë mënyrë që ju të mund të largoheni nga vendi i punës i juaj në rast të pauzës, edhe nëse punoni i vetëm. Andaj shefi juaj duhet ti përcaktojë në planin e punës edhe kohën e pauzave, ose edhe të organizojë një zëvendësim, ose të përshtatë orarin e hapjes së punës. Nëse nuk guxon të largoheni nga vendi i punës për pauzë, firma juaj duhet t'ju logarisë këtë kohë si kohë pune. Pauza vlen edhe më tej në tregtinë me pakicë si e pashfrytëzuar. Vetëm në raste absolutisht të jashtëzakonshme mund të tolerohet të bërit e pauzës në vend të punës. Dhe kjo vetëm atëherë kur në kuadër të sipërfaqes së shitjes ekziston një vend pauze i qetë, i pastër dhe i ndarë, në të cilin ju mund të ushqeheni dhe me të vërtetë të pushoni. Ky vend duhet të jetë në përputhje me plotësimin e kushteve të caktuara të mbrojtjes së shëndetit dhe posedimit të ujit të pijshëm, që mundëson një pamje natyre dhe që ofron një vende uljeje. E gjithë kjo në rastin e juaj nuk është e dhënë. Andaj në të vërtetë, ju as që keni shfrytëzuar pauzën!

Work, 16.8.2019

Më 1 shtator 2019 u fuqizua Marrëveshja për Sigurimet Shoqërore Zvicër-Kosovë Aplikimet për Pensionet e Zvicrës janë falas

Marrëveshja për sigurimet shoqërore midis Zvicrës dhe Kosovës ka hyrë në fuqi më datën 1 shtator 2019. Nga kjo datë shtetasit e Kosovës do të marrin përsëri pensionet nga Sigurimi i Pleqërisë, i Trashëgimtarëve dhe i Invaliditetit (AHV/IV, AVS/AI), edhe nëse ata banojnë jashtë Zvicrës, si p.sh. në Kosovë. Për të aplikuar për përfitime pranë Sigurimeve Shoqërore të Zvicrës nuk është i nevojshëm përfaqësimi nga avokatë, konsulentë apo persona të tjerë, të cilët kërkojnë para për shërbimet e tyre. Institucionet zbatuese të të dyja shteteve kanë për detyrë të ofrojnë këtë shërbim falas.

Osman Osmani

Sindikata Unia përmes këtij shkrimi ju informon mbi procedurat e aplikimit. Në faqen e Unia dhe pronintegra.ch i gjeni njoftimet zyrtare si dhe formularët zyrtar për përfitues të pensionit.

Nëse nuk keni qasje në internet, formularët mund t'i tërhiqni pranë përfaqësive Zvicërore jashtë Zvicrës si për shembull në Ambasadën e Zvicrës në Kosovë.

Personat të cilët aplikojnë mund të plotësojnë vetë formularët. Nëse gjatë plotësimit të formularëve paraqiten probleme, atëherë ata do të ndihmohen me kënaqësi nga bartësit e autorizuar të sigurimeve (Arka e kompensimit të AHV-së [Sigurimi i Pleqërisë dhe Trashëgimtarëve], zyra e IV [Sigurimi i Invaliditetit]).

Anëtarët e sindikatës Unia formularët mund t'i plotësojnë në sekretariatet e Unia në vendin ku janë të anëtarësuar.

Sindikalistët shqiptaro-zvicëranë do të angazhohen edhe me partnerët tanë si në Zvicër ashtu edhe në Kosovë tu sigurojnë të gjithë anëtarëve e pensionistëve me të drejtë përfitimi si dhe trashëgimtarëve të tyre mbështetje konkrete për plotësimin e formularëve e aplikimit për përfitime nga sigurimet shoqërore të Zvicrës. Në ditët në vijim do ti bëjmë publike edhe adresat tjera se ku mund të drejtohen të gjithë përfituesit dhe të prekurit e tjerë.

Për pyetje të mundshme sqaruese dhe gjithçka tjetër rreth botës së punës përfshi edhe sigurinë sociale mund të na shkruani në info@prointegra.ch apo në migration@unia.ch.

Në nyjat vijuese mund të shkarkoni formularët e lajmërimit për pension të pleqërisë AHV/IV, AVS/AI në gjuhët zyrtare të Zvicrës dhe në anglisht (DE, FR, IT, EN):

www.ahv-iv.ch/de/Merkblätter-Formulare/Formulare/Leistungen-der-AHV

Për më shumë shihni njoftimin përkatës zyrtar të Entit Federal për Sigurimet Shoqërore të Zvicrës në gjermanisht, shqip dhe në sllavishten jugore: www.bsv.admin.ch/bsv/de/home/sozialversicherungen/int/kosovo.html?fbclid=IwAR0060amDKFCNGUEnPMoLXHH7uyWJpZ06ijmJBNieUd8u190DHLn-ZVY

Kërkesat për pensione mund t'i bëni nëpër komuna dhe në Zyrat e Enteve të Pensioneve në Zvicër dhe Kosovë. Ju mund t'i merrni formularët e aplikimit për përfitimet zvicërore dhe të paraqisni kërkesat në institucionin e mëposhtëm të



Pamje nga aksioni simbolik gjatë kongresit të Unia para fjalës së minsitrit Beset

Aplikimi për të gjithë përfituesit që kanë vendbanimin në Zvicër

Përfitimet në rast të moshës dhe për trashëgimtarë (gratë e veja, burrat e ve dhe jetimët):

Schweizerische Ausgleichskasse SAK
Av. Edmond-Vaucher 18
Postfach
3100 Genf 2
Schweiz
Tel : +41 58 461 91 11
Faks: +4158 461 97 05
Internet: www.zas.admin.ch

Përfitimet nga sigurimi i invaliditetit:

V-Stelle für Versicherte mit Wohnsitz im Ausland IVSTA
Av. Edmond-Vaucher 18
Postfach
3100 Genf 2
Schweiz
Tel. +41 58 461 91 11
Faks +41 58 461 99 50
Internet: www.zas.admin.ch

Republikës së Kosovës (shih njoftimin e MPMS): <https://mpms.rks-gov.net/marreveshja-per-sigurime-sociale-me-zvicren-hyn-ne-fuqi-nga-1-shtatori-2019/>

Aplikimi për të gjithë përfituesit që kanë vendbanimin në Kosovë

Divizioni i Pensioneve të Jashtme
Departamenti i Pensioneve
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Rr. «Pashko Vasa» – Baraka Nr.1
10000 Prishtinë
Tel: 03 82002 6114
Republika e Kosovës

Kërkesat do të përcillen te organi kompetent në Zvicër.